



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:057725

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05633513

KPPP.nr.754/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përbarimore të kreditorit “Dim G.Spyridis SA, me seli në Greqi, 24 Athinon Avenus Athinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Tashko Pustina Attorneys – Dega në Kosovë, me seli në Prishtinë, kundër debitorit N.P.T. “Petrotek”, me NRB:70918811, me seli në Vushtrri, rruga “Skënderbeu” p.n., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.507/18 të datës 23.07.2018, të Përbaruesit Privat Kushtrim Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 29.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit N.P.T. “Petrotek”, dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri për lejimin e përbarimit P.nr.507/18 i datës 23.07.2018, i lejuar nga Përbaruesi Privat Kushtrim Metaj, për pjesën sa i përket detyrimit kryesor në shumën prej 23,040.00 € (njëzet e tre mijë e katërdhjetë euro).
- II. MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit për lejimin e përbarimit P.nr.4056/20 i datës 23.10.2020, i lejuar nga Përbaruesi Privat Atip Mustafa, sa i përket shpenzimeve të procedurës përbarimore.
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përbarimore e kreditorit “Dim G.Spyridis SA, ndaj debitorit N.P.T. “Petrotek”, sipas Urdhrit Përbarimor P.nr.507/18 të datës 23.07.2018, për detyrimin kryesor në shumën prej 23,040.00 € (njëzet e tre mijë e katërdhjetë euro).

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.507/18, të datës 23.07.2018, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturën Nr.07373 të datës 24.10.2014; Faturën Nr.10287 të datës 12.11.2015; Faturën Nr.02029 të datës 12.11.2015; Faturën Nr.10665 të datës 18.02.2016; Faturën Nr.02098 të datës 18.02.2016, dhe Faturën Nr.10912 të datës 13.05.2016, me të cilin është urdhëruar debitori që t'ia paguaj kreditorit shumën 23,830.00 €, me kamatë ligjore 8% deri në përmbushjen definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë, me bartjen e mjeteve financiare nga llogaria bankare e debitorit në llogarinë e veçantë bankare të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se është paraqitur nga personi i paautorizuar, pasi që autorizimi i cili gjendet në shkresat e lëndës nuk është i dhënë nga pronari i kreditorit. Tutje ka shtuar se faturat të cilat janë objekt i kësaj procedure përmbarimore nuk paraqesin dokument të përmbarueshëm, nuk ka dëshmi se të njëjtat janë dorëzuar dhe pranuar nga debitori, po ashtu shuma e kërkuar nga kreditori nuk është e qartë pasi që në disa vende ka kërkuar shumën prej 23,830.00 €, në disa vende ka kërkuar shumën prej 23,292.00 €, andaj është e pakuptueshme për debitorin se cila është shuma e cila është kërkuar nga kreditori. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet.

Kreditori në përgjigje në prapësimi përmes përfaqësuesit të autorizuar ka deklaruar se, debitori në prapësimin e paraqitur nuk e ka kundërshtuar raportin që ka pasur me kreditorin, nuk ka kundërshtuar porositjen e mallit, pranimin e mallit si dhe mos pagesën e faturave. Tutje ka theksuar se sa i përket pretendimit se propozimi për përmbarim është paraqitur nga personi i paautorizuar, nuk qëndron një pretendim i tillë pasi që autorizimi është dhënë nga kryetari i bordit të drejtorëve. Po ashtu në lidhje me pretendimin se faturat nuk janë pranuar nga debitori ka theksuar se nuk qëndron një pretendim i tillë pasi që debitori i ka pranuar në mënyrë të rregullt faturat si dhe ka njohur vlefshmërinë e tyre. Në lidhje me vlerën e kërkuar sipas propozimit për përmbarim ka theksuar se shuma themelore e pretenduar është 23,040.00 €, së bashku me kamatën 8%, si dhe shpenzimet e tjera në bazë të ligjit të zbatueshëm. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të aprovohet.

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, me aktvendimin CPP.nr.164/20, të datës 05.06.2020, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër

urdhrit përbarimor P.nr.507/18 të datës 23.07.2018, të lëshuar nga Përmbauesi Privat Kushtrim Metaj.

Debitori me datë 15.09.2020, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPP-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikim të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Gjykatës së Apelit, që të aprovohet ankesa, të ndryshohet aktvendimi i shkallës së parë.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.1328/22 të datës 10.03.2023, ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorit, ka anuluar aktvendimin e atakuar dhe çështja i është kthyer Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërejtjeve sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Dytë, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi është pjesërisht i bazuar për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozimin për përbarim dhe i lejuar me urdhrin e Përmbauesit Privat Kushtrim Metaj, P.nr.507/18 të datës 23.07.2018, në shumën prej 23,040.00 €, është përmbushur në tërësi.

Gjykata duke u bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, përkatësisht nga marrëveshja për pagesën e borxhit me këste e lidhur mes kreditorit dhe debitorit, palët janë dakorduar që pagesa e borxhit sipas faturave të cilat janë objekt i kësaj procedure përbarimore të bëhet përmes kësteve, debitori duke ju përmbajtur marrëveshjes ka bërë pagesat në kohë dhe atë sipas dëshmisë së pagesës me numër 00001312 të datës 07.08.2018, vërtetohet se debitori ka bërë pagesën e këstit të parë në shumën prej 12,500.00 €, sipas dëshmisë së pagesës me numër 00000965 të datës 27.08.2018, vërtetohet se debitori ka bërë pagesën e këstit të dytë në shumën prej 2,635.00 €, sipas dëshmisë së pagesës me numër 00004339 të datës 01.10.2018, vërtetohet se debitori ka bërë pagesën e këstit të tretë në shumën prej 2,635.00 €, sipas dëshmisë së pagesës me numër 00000654 të datës 02.11.2018, vërtetohet se debitori ka bërë pagesën e këstit të katërt

në shumën prej 2,635.00 €, si dhe sipas dëshmisë së pagesës me numër 00001535 të datës 03.12.2018, vërtetohet se debitori ka bërë pagesën e kështit të pestë në shumën prej 2,635.00, andaj nga këto pagesa të realizuara nga debitori për kreditorin vërtetohet fakti se debitori ka përmbushur në tërësi borxhin ndaj kreditorit sipas faturave të cilat janë objekt i kësaj procedure përbarimore dhe atë shumën prej 23,040.00 €, andaj vlerësoi se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar dhe duke u mbështetur në nenin 71 par.1 nën par.1.2, të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përbarimor ose urdhri përbarimor është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”*, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, pasi që faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri përbarimor, e kanë humbur efektin juridik, sepse të njëjtat janë përmbushur në tërësi nga ana e debitorit.

Gjykata në kuptim të nenit 4 paragrafit 4 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore, në të cilën theksohet se *“përveç tarifës së efikasitetit të përbarimit, e cila përcaktohet me marrëveshje në mes të përbaruesit privat dhe kreditorit, tarifat tjera paraprakisht paguhen nga kreditorit dhe pas përfundimit të procedurës, ato i ngarkohen debitorit”*, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, meqenëse kreditori i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës përbarimore që janë krijuar prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, i cili është lejuar me urdhrin përbarimor të Përbaruesit Privat Kushtrim Metaj, P.nr.507/18 të datës 23.07.2018. Andaj gjykata vlerësoi se shpenzimet e përbarimit janë krijuar nga ana e debitorit, pasi që i njëjti detyrimin e tij ndaj kreditorit e ka përmbushur pas inicimit të procedurës përbarimore dhe zhvillimit të procedurës deri në këtë fazë.

Andaj nisur nga fakti se në rastin konkret debitori e ka paguar në tërësi detyrimin e tij ndaj kreditorit, si dhe duke u bazuar në nenin 66 paragrafin 4 të LPP-së i cili përcakton se: *“Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përbarimore”*, dhe nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përbarimit si rrjedhojë e përmbushjes në tërësi të kredisë

në të holla të palës kreditore, ndërsa urdhrin përmbartimor e la në fuqi, vetëm sa i përket pjesës së shpenzimeve të procedurës përmbartimore.

Gjykata në kuptim të nenit 66 par. 4, nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 4 par. 4, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.754/23, datë 29.04.2024

Gjyqtarja

Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.